

V E N D I M

Nr.283, datë 18.6.1999

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE, QË NUK JANË SHITUR SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.192, DATË 20.3.1998 "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHITETËRORE, QË PRIVATIZOHET DHE PËR PROCEDURAT E SHITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I

1. Për të gjitha objektet e listës bashkëlidhur, të cilat nuk kanë mundur të shiten edhe me uljen e VAM-it, sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, zhatohet shitja me rezervë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.195, datë 20.3.1998.

2. Shitja me rezervë të bëhet nëpërmjet shitjes me këste të objekteve, në afate kohore deri në 10 vjet, sipas vlerës së ndërmarrjes, me VAM të ulur. Shitja me rezervë të bëhet me ankand të hapur. Kriteri bazë për fituesit e ankandit të jetë shlyerja e çmimit të shitjes në afatin më të shkurtër kohor. Ish-pronarët e truallit përfitojnë të drejtën e parablerjes, sipas kapitullit III pika 2a e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998. Përcaktimi i kësteve dhe vlerat përkatëse të çdo kësti të parashikohen në kontratën e shitjes nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

3. Procedurat e publikimit për shitjen me rezervë fillojnë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit menjëherë pas përfundimit të ankandit të kryer sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998, duke njoftuar zyrtarisht edhe Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Vlera e ankandit të jetë fikse, VAM-i i ulur. Në këtë ankand nuk ka asnjë kufizim për pjesëmarrjen.

4. Procedurat për publikimin e zhvillimit të ankandit të jenë si vijon:

a. Vendoset njoftimi me tri gazeta me qarkullim kombëtar të paktën katër herë, të marra së bashku, në 10 ditë e para.

b. Periudha e publikimit të jetë jo më pak se 15 ditë nga njoftimi i parë.

c. Njoftimet të bëhen në po ato vende ku janë bërë publikimet e dy raundeve të para dhe me të njëjtën informacion, duke shtuar formën e shitjes me rezervë.

5. Detyrat dhe të drejtat e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit rregullohen sipas dispozitave përkatëse të kapitujve III dhe IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998.

6. Në rastet kur edhe pas zbatimit të shitjes me rezervë nuk do të paraqitet asnjë blerës, të zhvillohet një ankand tjetër, pa përcaktimin e vlerës së objektit. Ankandi të bëhet me zarfa të mbyllur. Fitues ankandi do të jetë personi që paraqet vlerën më të lartë. Në rast të vlerave të barabarta atëherë do të hidhet shorti për përcaktimin e fituesit. Ish-pronarët e truallit përfitojnë të drejtën e parablerjes, sipas kapitullit III, pika 2a e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192,

datë 20.3.1998. Pagesa në këtë ankand do të jetë me një kësht. Procedurat e publikimit për këtë lloj ankand do të bëhen sipas pikës 4 të këtij vendimi, duke përcaktuar në pikën "c" të saj formën e shitjes pa vlerë të objektit.

7. Në rastet kur edhe pas ankandit, të kryer sipas pikës 6, nuk paraqitet asnjë blerës, atëherë ndërmarritet apo objektet të administrohen sipas përcaktimeve të bëra në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998.

8. Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 6 të përcaktohen me urdhër të Kryetarit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Cdo rregull shtesë do të jetë pjesë e publikimit.

9. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko